



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 191

Tiranë – E mërkurë, 1 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 607, datë 27.10.2017	Për kalimin e mjediseve të ndërtesës “Godina e Inovacionit” në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)..... 9415
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 27.10.2017	Për miratimin e kontratës së qirasë së rinegociuar, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe shoqërisë “Continental Group” sh.a..... 9418
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 27.10.2017	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga tokë “arë” në tokë “trual”, për ndërtimin e objektit “vepër industriale - magazinë”, në njësinë administrative Kashar, bashkia Tiranë, me zhvillues shoqërinë “Marketing & Distribution” sh.p.k..... 9430
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 27.10.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 7, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2017 në njësitë e qeverisjes qendrore”..... 9432
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 27.10.2017	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës..... 9433
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 27.10.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2017”..... 9439
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 615, datë 27.10.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 645, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”..... 9440

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 27.10.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi dhe rivitalizimi i parkut “Aqif Pasha””, në Bashkinë e Elbasanit.....	9440
Urdhër i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 112, datë 26.10.2017	Për delegim kompetence.....	9441
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 521, datë 18.10.2017	Për delegimin e kompetencave.....	9441
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 40, datë 6.10.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Tiranë.....	9442
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 41, datë 6.10.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Gramsh.....	9442
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 43, datë 6.10.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 33, datë 6.9.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Maliq”	9443
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 44, datë 6.10.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Lezhë.....	9443

**VENDIM****Nr. 607, datë 27.10.2017****PËR KALIMIN E MJEDISEVE
TË NDËRTESES “GODINA E
INOACIONIT” NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË
SË INFORMACIONIT (AKSHI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ndërtesës “Godina e inovacionit”, me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga “Papa Gjon Pali”, nr. 3, kalojnë në përgjegjësi administrimi tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për mjedise pune, për ushtrimin e veprimtarisë së saj administrative, sipas planimetrisë, dhënë në anekset bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- Aneksi 1, në katin nëntokë (-1), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i kalojnë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja 546 (pesëqind e dyzet e gjashtë) m², sipërfaqja 490 (katërqind e nëntëdhjetë) m² dhe sipërfaqja 535 (pesëqind e tridhjetë e pesë) m².

- Aneksi 2, në katin përdhes (0), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i kalojnë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja 937 (nëntëqind e tridhjetë e shtatë) m², sipërfaqja 90 (nëntëdhjetë) m², sipërfaqja 90 (nëntëdhjetë) m² dhe sipërfaqja 454 (katërqind e pesëdhjetë e katër) m².

- Aneksi 3, në katin e parë (1), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i kalojnë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja 815 (tetëqind e pesëmbëdhjetë) m², sipërfaqja 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m² dhe sipërfaqja 385 (treqind e tetëdhjetë e pesë) m².

- Aneksi 4, në katin e dytë (2), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i kalojnë në përgjegjësi administrimi sipërfaqja 700 (shtatëqind) m² dhe sipërfaqja 871 (tetëqind e shtatëdhjetë e një) m².

2. Në katin e parë (1), mjedisi me sipërfaqe 815 (tetëqind e pesëmbëdhjetë) m² t'i jepet në përdorim për një afat të pacaktuar Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), për ushtrimin e veprimtarisë së tij administrative.

3. Në katin e parë (1), mjedisi me sipërfaqe 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m² t'i jepet në përdorim deri më 31 dhjetor 2018 qendrës “Protik ICT Resource Center” për ushtrimin e veprimtarisë së saj administrative.

4. Në katin e parë (1), mjedisi me sipërfaqe 385 (treqind e tetëdhjetë e pesë) m² t'i jepet në përdorim për një afat të pacaktuar Komisionit të Prokurimit Publik për ushtrimin e veprimtarisë së tij administrative.

5. Në katin e dytë (2), mjedisi me sipërfaqe 700 (shtatëqind) m² t'i jepet në përdorim për një afat të pacaktuar Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), për ushtrimin e veprimtarisë së tij administrative.

6. Vendimi nr. 34, datë 20.1.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje prej 871 m², në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), projekti “Innovation Hub”, shfuqizohet.

7. Vendimi nr. 974, datë 2.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) e të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe në përdorim të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE) e të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), të mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-Inima”, shfuqizohet.

8. Institucioneve të cilat kanë në përgjegjësi administrimi apo në përdorim mjediset e godinës, u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronës, t'i tjetërsojnë ato apo t'ua japin në përdorim të tretëve.


9. Ngarkohen Kryeministria, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama



GODINA INOVACIONIT
ANEKSI 1
KATI NENTOKE (-1)



GODINA INOVACIONIT
ANEKSI 2
KATI PERDHE (0)






GODINA INOVACIONIT
ANEKSI 3
KATI PARE (1)



GODINA INOVACIONIT
ANEKSI 4
KATI DYTE (2)





VENDIM

Nr. 608, datë 27.10.2017

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË
QIRASË SË RINEGOCIUAR, NDËRMJET
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
DOGANAVE DHE SHOQËRISË
“CONTINENTAL GROUP” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 801 dhe vijuese të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 708, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, shtrirjen territoriale dhe klasifikimin e zonës së përhershme doganore Tiranë (Vorë – Muçaj)”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së qirasë së rinegociuar, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe shoqërisë “Continental Group” sh.a., sipas tekstit të amendamentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e qirasë, për periudhën nga hyrja në fuqi e kontratës deri në dhjetor 2017, do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Fondi në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është në shumën prej 19 255 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekësh.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të parashikojë në buxhetin e saj fonde për përballimin e pagesës së qirasë, sipas afatit kontraktor për periudhën në vijim.


4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 5134 REP.
NR. 3042 KOL.



**AMENDAMENT
PËR KONTRATËN E QIRASË
NR. 5381 REP., 2494 KOL. DATE 29.12.2012**

Sot në Tiranë, më 02/10 /2017, përpara meje Mimoza Sadushaj, Notere me seli në adresën Rr. "Vaso Pasha", Pallati 13/1, Tiranë, Shqipëri, hartohet ky Amendament për Kontratën e Qirase nr. 5381 Rep., 2494 Kol. datë 29.12.2012, të noteres Mimoza Sadushi, ndërmjet:

Shoqëria "Continental Group" sh.a., e regjistruar pranë QKB me NIPT K01611001B me seli në adresën, Vorë, Tiranë, përfaqësuar nga administrator z. Shefqet Jata, i biri i Rexhepit, lindur në Kukës me dt. 14.01.1960 dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit nr.G00114126J, këtu e më poshtë referohet **"Qiradhënësi"**

si dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm zj. Belinda Ikonomi, e bija e Viktorit, lindur në Gerae e datëlindjes 08.08.1975, banuese në Gerae, mbajtëse e letërnjoftimit nr. B 1576 82 47, e autorizuar nëpërmjet VKM nr. 708 date 12.10.2016 "Për krijimin, shtrirjen territoriale dhe klasifikimin e Zonës së Përherhshme Doganore Tiranë (Vorë-Muçaj)" këtu e më poshtë referohet **"Qiramarrësi"**;

Qiradhënësi dhe Qiramarrësi bashkërisht, këtu dhe më poshtë referohen si **"Palët"**.

BAZA LIGJORE:

Amendimi i kësaj kontrate hartohet bazuar në nenin 801 dhe vijues të Kodit Civil, në ligjin 102/2014, Kodi Doganor, i ndryshuar, në VKM nr. 708 datë 12.10.2016 "Për krijimin, shtrirjen territoriale dhe klasifikimin e Zonës së Përherhshme Doganore Tiranë (Vorë-Muçaj) si dhe në pikën 15.4 të Kontratës së Qirasë Nr. 5381 Rep., 2494 kol., datë 29.12.2012 të noteres Mimoza Sadushi,

KUSHTE PARAPRAKE

Ndërsa, Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr. 708 date 12.10.2016, referuar ndryshimeve të Kodi Doganor, miratuar me ligjin nr 102/2014, të ndryshuar, ka vendosur krijimin e Zonës së Përherhshme Doganore Tiranë (Vorë-Muçaj), në brendësi të territorit të Republikës së Shqipërisë, me shtrirje 71.654 m², si dhe ka autorizuar Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të rinegociojë dhe nënshkruaie kontratën e qirasë së lidhur me Qiradhënësin;



Ndërsa, Qiradhënësi dhe Grupi Negociator, i ngritur me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 107 datë 17.11.2016, të ndryshuar, në zbatim të VKM-së nr. 708 datë 12.10.2016, kanë zhvilluar takime për rinegocimin e kushteve të kontratës dhe ka një dakordësi midis palëve, mbi bazën e të cilave amendohet Kontrata e Qirasë nr. 5381 Rep., 2494 Kol., datë 29.12.2012 dhe anëksat bashkëlidhur, të cilët janë pjesë e integrale e saj.

Ndërsa, shoqëria “Continental Group” sh.a ka rënë dakord, për heqjen e detyrimit nga kontrata aktuale për kryerjen e të gjitha procedurave doganore vetëm në Terminalin Doganor të Degës së Doganës Tiranë, për të gjitha mjetet, për importin, eksportin apo regjimet doganore për gjithë operatorët e vendosur dhe regjistruar në Qarkun e Tiranës, si dhe heqjen e të gjitha parashikimeve ligjore për dëmshpërblim apo penalitete lidhur me të ardhurat e përcaktuara të “Continental Group” sh.a, nga moszbatimi nga ana e DPD të kompetencës territoriale;

Ndërsa, shoqëria “Continental Group” sh.a ka rënë dakord, për heqjen dorë nga të gjitha kërkesat dhe pretendimet për shkaktim dëmi, fitim të munguar apo kamatëvonesa, si dhe çdo pretendim tjetër i bërë me dije mes palëve apo pretendim i ri eventual që është krijuar gjatë zbatimit të deritanishëm dhe që lidhet me veprime apo mosveprime të palëve deri në datën e nënshkrimit të kontratës së rinegociuar, si dhe çdo kërkesë apo pretendim që është aktualisht në proces gjyqësor dhe ka të bëjë me mosmarrëveshje të krijuara deri në datën e nënshkrimit të kontratës së rinegociuar, duke përfshirë ato të cilat janë njohur nga gjykata, cilado qoftë shkalla e gjykimit;

Ndërsa, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave – Dega e Doganës Tiranë bie dakord, që të paguajë qira direkte për ambientet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të saj, të evidentuara sipas rilevimeve topografike.

PRANDAJ, palët bien dakord të hartojnë këtë amendament si më poshtë:

NENI 1

PERKUFIZIME

Në Kontratën e Qirasë nr. 5381 Rep., 2494 Kol., datë 29.12.2012, të noterës Mimoza Sadushi, përkufizimet e më poshtme riformulohen, shtohen apo shfuqizohen si vijon:

- 1.1 **Çdo referim** në Kontratën e Qirasë Nr. 5381 Rep., 2494 kol., datë 29.12.2012, ku është shprehur “Terminal Doganor i Degës së Doganës Tiranë” do të zëvendësohet me termin “Zona e Përherëshme Doganore Tiranë, (Vorë-Muçaj).”
- 1.2 **Tek përkufizimi “Shpërblim jo i drejtpërdrejtë”**, togfjalëshi “Tarifa e peshimit” shfuqizohet.
- 1.3 **Përkufizimi “Legjislacion”** riformulohet si më poshtë vijon:
“Legjislacion do të kuptohet, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare me fuqi detyruese në Republikën e Shqipërisë, Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Kodi Doganor dhe dispozitat zbatuese të tij, të ndryshuar si dhe



VKM nr. 708 date 12.10.2016 “Per krijimin, shtrirjen territoriale dhe klasifikimin e Zonës së Përhershme Doganore Tiranë (Vorë-Muçaj).”

1.4 Termi “Operator” riformulohet si më poshtë:

“Operator Ekonomik” është personi i cili gjatë aktivitetit të tij tregtar përfshihet në veprime të mbuluara nga legjislacioni doganor.

1.5 Termi “pa shpërblim” në kontratë zëvendësohet me termin “me qira direkte”.

1.6 “Qira direkte” do të thotë vlera totale e qirasë sipas Aneksit 7, të ambienteve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të palës qiramarrëse të evidentuara sipas rlevimeve topografike, Aneksi 8.

NENI 2

Në nenin 2, pika 2.1, togfjalëshi “pa shpërblim të drejtpërdrejtë”, zëvendësohet me togfjalëshin “pjesërisht me qira direkte dhe pjesërisht me shpërblim jo të drejtpërdrejtë.”

NENI 3

Në nenin 3, pika 3.1, togfjalëshi “me qira pa shpërblim të drejtpërdrejtë”, zëvendësohet me togfjalëshin “pjesërisht me qira direkte dhe pjesërisht me shpërblim jo të drejtpërdrejtë.”

NENI 4

Neni 5, “Çmimi i Kontratës”, riformulohet si më poshtë:

“5.1 Objekti i parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate do t’i vihet në dispozicion Qiramarrësit përkundrejt qirasë direkte dhe shpërblimit jo të drejtpërdrejtë, si më poshtë:

A. Me qira direkte:

A.1 Qiraja mujore prej 5,348,870 (pesë milion e treqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë në muaj pa TVSH (sipas çmimeve të përcaktuara në Aneksin 7,) për ambientet e përcaktuara në Aneksin 6 dhe 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

B. Ambientet me shpërblim jo të drejtpërdrejtë:

B.1 Ambientet për operatorët ekonomikë, operatorët ekonomikë ndihmës dhe shërbime shtesë me përshkrime dhe tarifa sipas Aneksit 2, bashkëlidhur kontratës, pjesë përbërëse e saj.

Për çdo shërbim apo ambient tjetër përveç sa është parashikuar në këtë nen, sipas çmimeve të tregut të lirë, bazuar në kërkesë-ofertën.

5.2 Vlera e Qirasë Direkte, do të paguhet e plotë nga Qiramarrësi në favor të Qiradhënësit brenda datës 5 (pesë), të muajit pasardhës në llogarinë bankare me të dhënat:

Banka SOCIETE GENERAL ALBANIA SHA

Numër llogarie 0000106262158 /Emri CONTINENTAL GROUP SHA

Swift Code PUPPALTR



BAN AL09213110440000000001062158.

5.3 Në rast se Qiramarrësi nuk paguan qiranë mujore të plotë brenda datës 5, për çdo ditë vonesë, për vlerën e papaguar aplikohet interes sipas interesave të Bankës së Shqipërisë.

5.4 Në rast se Qiramarrësi do të kërkojë me qira ambiente të tjera, përveç atyre të përcaktuara më sipër dhe të detajuara në Aneksin 6, palët kanë të drejtë të negociojnë duke aplikuar çmimet e tregut të lirë.”

NENI 5

Në nenin 7, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

- a) në pikën 7.3, togfjalëshi “shpërblim jo i drejtpërdrejtë”, zëvendësohet me fjalën “direkte” dhe në fund të pikës 7.3, shtohet fjalia me përmbajtje: “përfshijë punimet për mirëmbajtjen e përditshme dhe zëvendësimin e materialeve të konsumit që janë në ngarkim të qiramarrësit.”
- b) në pikën 7.8, hiqet togfjalëshi “i peshimit të automjeteve” dhe në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “ sipas Aneksit 2.”

NENI 6

Në nenin 8, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

- a) Pikat 8.4, 8.5, 8.6 dhe 8.7, shfuqizohen.
- b) Pika 8.8, riformulohet si më poshtë:

“ 8.8 Qiramarrësi:

- a) nuk mbart detyrim për kryerjen e të gjitha procedurave doganore vetëm në Terminalin Doganor të Degës së Doganës Tiranë;
- b) për çdo operator ekonomik që kryen procedura doganore në Zonën e Përherëshme Doganore Tiranë (Vorë - Mucaj) sipas përcaktimeve të legjislacionit doganor (ligjin, aktet nënligjore, rregullore, udhëzime, urdhra, etj.), i kryen ato brenda kësaj zone.”
- c) Pas pikës 8.11, shtohen pikat 8.12 dhe 8.13, me përmbajtjen si më poshtë:
 - “8.12 Ambientet objekt qiraje direkte, do të përdoren specifikisht në ushtrim të funksionit të autoritetit doganor (kontroll, mallra të sekuestruara, peshim e matje, parkim mjeteve të bllokuara, si dhe parkim mjeteve të administratës, arkivë), për të cilat Qiradhënësi nuk ka të drejtë të vjelë të ardhura. Administrimi, mbikëqyrja dhe kontrolli në këto ambiente bëhet nga Qiramarrësi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë kontratë.
 - 8.13 Qiramarrësi bie dakort që ambientet objekt qiraje direkte nuk do të nënkontraktohen”.

NENI 7

Në nenin 9 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

- a) Pika 9.5, shfuqizohet.
- b) Pika 9.6, riformulohet si më poshtë:



“9.6 Ambientet e vëna në dispozicion me shpërblim jo të drejtpërdrejtë administrohen nga qiradhënësi për efekt të pagesës së tarifës së parkimit të përcaktuar në Aneksin 2.”

NENI 8

Në nenin 10, pika 10.5, ndryshon si më poshtë vijon:

“10.5 Në rast se njëra nga palët, me veprime apo mosveprime direkte apo indirekte, cenon të drejtat dhe detyrimet e palës tjetër që burojnë nga kjo kontratë, detyrohet të shpërblejë sipas rastit palën tjetër, në masën 100% të vlerës së dëmit të shkaktuar, kamatëvonesat dhe fitimin e munguar në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.”

NENI 9

Neni 11 riformulohet si më poshtë:

“11.1 Palët do të njoftojnë njëra tjetrën në kontaktet e mëposhtme:

Qiradhënësi, në adresën e emailit: info@continentalvora.al

Qiramarrësi, në adresën e emailit: doganatiranë@dogana.gov.al

11.2 Në adresat respektive,

Qiradhënësi, në adresën : Vorë, Tiranë

Qiramarrësi, në adresën Rr. “Dritan Hoxha”, Laprakë, Tiranë.

11.3 Në rast se palët do të ndryshojnë adresat e kontaktit, ato duhet të njoftojnë me shkrim njëra tjetrën dy javë para.”

NENI 10

Në nenin 13, togfjalëshi “Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë”, zëvendësohet me togfjalëshin “Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.”

NENI 11

Në nenin 14, pika 14.2, shfuqizohet.

NENI 12

Ndryshime në Anekse

1. Shkronja A, e Aneksit 2, riformulohet: “A. Të gjitha ambientet sipas rilevimit topografik të përcaktuar në Aneksin 8, për të cilat qiramarrësi nuk paguan qira direkte.”
Pas pikës 4, të shkronjës B, shtohen pikat 5 dhe 6 me përmbajtje si më poshtë vijon:
“5. Çmimi mesatar i qirasë për agjencitë doganore dhe operatorët e tjerë ndihmës 1,500 lekë/m² pa TVSH.
6. Çmimi mesatar i qirasë për bankat 2,000 lekë/m² pa TVSH.”
2. Aneksi 3, shfuqizohet.
3. Aneksi 4 “Tarifat e parkimit të mjeteve” shfuqizohet.



Pas aneksit 5, shtohen: Aneksi 6 “Ambientet objekt qiraje direkte”, Aneksi 7 “Çmimi i qirasë direkte” dhe Aneksi 8 “Rilevimi topografik”, që i bashkëlidhen këtij amendamenti dhe janë pjesë integrale e kontratës së qirasë.

NENI 13 Dispozita te tjera

1. Dakordësimet nr. 4766 prot., datë 23.02.2017, i bashkëlidhen këtij Amendamenti dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ky Amendament është hartuar në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Brenda 3 (tre) muajve nga nënshkrimi i këtij amendamenti, Dega e Doganës Tiranë dhe qiradhënësi do të miratojnë një protokoll operimi, përmes të cilit do të përcaktohen modalitetet në lidhje me regjistrimet, hyrje-daljen e mjeteve dhe rrjedhën e punës, trajtimin dhe menaxhimin e tyre.
4. Palët duhet të respektojnë dispozitat e Kontratës dhe këtij Amendamenti. Për çështjet e papërcaktuara në Kontratë, ose në Amendament, do të aplikohet Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Kodi Doganor, i ndryshuar dhe dispozitat zbatuese të tij, si dhe VKM nr. 708, datë 12.10.2016 “Per krijimin, shtrirjen territoriale dhe klasifikimin e Zonës së Përhershme Doganore Tiranë (Vorë-Muçaj).
5. Palët bien dakord se ky Amendament do të bëhet pjesë integrale e kontratës.
6. Kontrata do të mbetet në fuqi të plotë, e pamodifikuar, përveç përcaktimeve të këtij Amendamenti.
7. Në rast konflikti mes termave dhe kushteve të Kontratës dhe këtij Amendamenti, ky Amendament do të ketë prioritet.
8. Ky amendament dhe të drejtat e detyrimet që parashikohen në të, hyn në fuqi në datën e miratimit nga Këshilli i Ministrave.
9. Ky Amendament është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Unë, Noteri pasi ua lexova me zë të lartë Palëve, këtë Akt, u binda se palët e gjejnë këtë Akt në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe unë vërtetoj nënshkrimin e tyre në përputhje me ligjin.

PALËT

QIRADHËNËSI

Shoqëria “Continental Group” sh.a
Administrator

Shefqet Jata

QIRAMARRËSI

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave
Drejtor i Përgjithshëm

Belinda Ikonomi

NOTERE



ANEKSI 6

AMBIENTET OBJEKT QIRAJE DIREKTE DHE AMBIENTET OBJEKT I SHPËRBLIMIT JO TË DREJTPËRDREJTË

(I) AMBIENTET OBJEKT QIRAJE DIREKTE:

a) Zyrat e Administratës

- Sip.N1; Godina Administratës 2 kätëshe = 1.426 m²

b) Magazinim/Kontroll/Sekuestro

- Sip. N2 = 1.007 m², para magazinave, e mbuluar, pa rrethim/ndërtim, aktualisht përdoret për Kontroll Fizik
- Sip. N3 = 377 m², Magazina Sekuestro dhe Arshive (5 qepena, 2 përdoren nga Magazina, 3 nga Arkiva)
- Sip. N5 = 270 m², Arshivë D.P.Doganave
- Sip. N6 = 216 m², e mbuluar, pa rrethim/ndërtim, pjesa para arshivës së D.P.Doganave

c) Parkim/Sipërfaqe funksionale

- Sip. S1; Zonë e Kontrollit Fizik = 2.557 m²
- Sip.S2; Zonë e Kontrollit Fizik = 787.5 m² (gjysma e sipërfaqes së evidentuar në rilevim)
- Sip.S3; Zonë e Kontrollit Fizik = 3.200 m²
- Sip.S4; Zonë Parking = 954 m²
- Sip.S5; Zonë Parking = 1.537 m²
- Sip.S6; Zona Hyrëse = 1.160 m², (përfshi Sip.N4(3) = 93m², Vend Kontrolli)

d) Peshoret

- Sip.P1 dhe Sip.P2

(II) AMBIENTET OBJEKT I SHPËRBLIMIT JO TË DREJTPËRDREJTË:

B.1 Ambientet për operatorët ekonomikë, operatorët ekonomikë ndihmës dhe shërbime shtesë me përshkrime dhe tarifa sipas Aneksit 2, bashkëlidhur kontratës, pjesë përbërëse e saj.



ANEKSI 7 ÇMIMI I QIRASE DIREKTE

A. Çmimi i qirasë mujore paguhet në lekë, korrigjuar me normën e inflacionit vjetor të shpallur nga Banka e Shqipërisë dhe mbi të aplikohet TVSH.

Përlllogaritja sipas Planit të Rilëvimit Topografik Aneksi 8, çmimeve të dakordësuara mes palëve në këtë aneks, sipas specifikimeve të mëposhtme dhe tabelës së detajuar:

A1. Për Zyrrat e Administratës, 1.100 lekë/m².

A2. Për magazinat, sipërfaqet e mbuluara (magazinim/kontroll fizik) dhe parkim/sipërfaqe funksionale, respektivisht:

- për magazinat, 450 lekë/m²,
- për sipërfaqet e mbuluara, 300 lekë/m²,
- për parkim/sipërfaqe funksionale, 200 lekë/m².

A3. Për peshoret, 1.083.120 lekë.

Tabela e përlllogaritjeve të çmimit të qirasë mbështetur në sipërfaqe të përcaktuara sipas rilëvimit topografik dhe çmimit të dakordësuar për çdo objekt dhe sipërfaqe

Nr	Germa	Emertimi	m ²	Çmimi për m ² pa tvsh	Vlera Qerese pa tvsh
				Leke	Leke
1	A	Ndërtesë e Administratës së Doganës (N1)	1,426	1,100.0	1,568,600
2	B	Magazina e Sekuestros (N3) (e mbuluar e pa rrethuar ku procesohen mjetet)	377	450.0	169,650
3		Magazina e Sekuestros (e mbuluar e pa rrethuar ku procesohen mjetet) (N 2)	1,007	300.0	302,100
4		Magazina e Arshivës N5	270	450.0	121,500
5		Magazina e Arshivës (e mbuluar, përdoret nga DPD) N6	216	300.0	64,800
6	C	Sipërfaqe funksionale/parkimi + kontroll fizik (S1 - S6, N4)	10,195.5	200.0	2,039,100
7	D	Peshoret (P1 + P2)			1,083,120
					5,348,870

ANEKSI 8 RILEVIMI TOPOGRAFIK




DHBKJ
Sek. A. Protokolit

Pa afjen Grupit Negociator

nr. 2.17

DAKORDËSIME



midis Grupit Negociator dhe "Continental Group" sh.a., mbi alternativën e qerasë direkte për kontratën nr 5381 rep. dhe 2494 kol. Datë 29.12.2012

Lidhur me alternativën e negociuar të qerasë direkte, Palët bien dakord sa më poshtë:

1. Pala qiradhënëse 'Continental Group' sh.a., bie dakord për *heqjen e detyrimit* nga kontrata aktuale për kryerjen e të gjitha procedurave doganore vetëm në Terminalin Doganor të Degës së Doganës Tiranë, për të gjitha mjetet, për importin, eksportin apo regjimet doganore për gjithë operatorët e vendosur dhe regjistruar në Qarkun e Tiranës, si dhe heqjen e të gjitha parashikimeve ligjore për dëmshpërblim apo penalitete lidhur me të ardhurat e porealizuara të "Continental Group" sh.a nga moszbatimi nga ana e DPD të kompetencës territoriale si më sipër cituar, shprehur në nenin 8 e vijues, në nenin 10 etj. të kontratës dhe në çdo klauzolë tjetër kontraktore që lidhet me këtë detyrim.

2. Pala qiradhënëse 'Continental Group' sh.a., bie dakord për *heqjen dorë* nga të gjitha kërkesat dhe pretendimet për shkaktim dëmi, fitim të munguar apo kamatëvonesa, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - a) kërkesat/prendimet për dëm, kamatvonesë, penalitet, fitim i munguar për moszbatim të kompetencës territoriale apo dispozitave të peshimit në vlerën 2.8 milion Euro
 - b) kërkesat/prendimet për detyrim të papaguar, kamatvonesë, penalitet, për:
 - Magazinat e Arshivës 900.000 Lekë (përfshi shtesat deri në nënshkrimin e kontratës),
 - Mjetet e bllokuara nga Crown Agents 23,341,800 Lekë (përfshi shtesat deri në nënshkrimin e kontratës),
 - Mjetet e personelit të Crown Agents 2,219,995 Lekë (sipas vendimit të gjykatës), si dhe çdo pretendim tjetër, i bërë me dije mes palëve apo pretendim i ri eventual, që është krijuar gjatë zbatimit të deritanishëm dhe që lidhet me veprime apo mosveprime të palëve deri në datën e nënshkrimit të kontratës së rinegociuar, si dhe çdo kërkesë apo pretendim që është aktualisht në proces gjyqësor duke përfshirë ato të cilat janë njohur nga gjykata, cilado qoftë shkalla e gjykimit.
3. Dakordësia e shprehur në pikën 1 dhe 2 nuk përfshin heqjen dorë në të ardhmen nga kërkitime për detyrime, penalitete, kamatvonesa apo dëmshpërblime të cilat do të krijohen pas hyrjes në fuqi dhe gjatë zbatimit të kontratës së rinegociuar. Kërkimi i tyre është e drejtë reciproke e të dy palëve bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Pala qiramarrëse "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave- Dega e Doganës Tiranë" bie dakord që të paguajë qira direkte për ambientet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të saj, të evidentuara sipas rilevimeve topografike:



a) Zyra të Administratës

- Sip.N1; Godina Administratës 2 katëshe = 1.426 m²

b) Magazinin/Kontroll/Sekuestro

- Sip. N2 = 1.007 m², para magazinave, e mbuluar, pa rrethim/ndërtim, aktualisht përdoret për Kontroll Fizik
- Sip. N3 = 377 m², Magazina Sekuestro dhe Arshive (5 qepena, 2 përdoren nga Magazina, 3 nga Arkiva)
- Sip. N5 = 270 m², Arshivë D.P.Doganave
- Sip. N6 = 216 m², e mbuluar, pa rrethim/ndërtim, pjesa para arshivës së D.P.Doganave

c) Parkim/Sipërfaqe funksionale

- Sip. S1; Zonë e Kontrollit Fizik = 2.557 m²
- Sip.S2; Zonë e Kontrollit Fizik = 787.5 m² (gjysma e sipërfaqes së evidentuar në rilevim)
- Sip.S3; Zonë e Kontrollit Fizik = 3.200 m²
- Sip.S4; Zonë Parking = 954 m²
- Sip.S5; Zonë Parking = 1.537 m²
- Sip.S6; Zona Hyrëse = 1.160 m², (përfshi Sip.N4(3) = 93m², Vend Kontrolli)

d) Peshoret

- Sip.P1 dhe Sip.P2

Rilevimet topografike, me ndryshimet për Sip.S2, të bëhen pjesë e anekseve të kontratës së rishikuar.

5. Palët bien dakord se çmimet që do të aplikohen do të jenë:

- Për Zyrat e Administratës, çmimi i negociuar prej 1.100 lekë/m²
- Për magazinat, sipërfaqet e mbuluara (magazinin/kontroll fizik) dhe parkim/sipërfaqe funksionale, sipas vlerësimit të raportit të ekspertit të kontraktuar nga Dogana, respektivisht:
 - për magazinat çmimi 450 lekë/m²,
 - për sipërfaqet e mbuluara 300 lekë/m² dhe
 - për parkim/sipërfaqe funksionale 200 lekë/m².



- c. Për peshoret, bazuar mbi të ardhurat faktike në shumën 1.083.120 lekë/muaj (mesatarja mujore e të ardhurave nga peshimi gjatë vitit 2016:
15597 peshime x 833.33 lekë / 12 muaj)
- d. Çmimet e mësipërme janë neto, pa TVSH.
- e. Çmimet e mësipërme do të përcaktohen në lekë korrektuar me normën e inflacionit mujor të shpallur nga Banka e Shqipërisë, ose çmimet përcaktohen në Euro me kursin zyrtar ditën e nënshkrimit të kontratës dhe pagesa kryhet në Euro ose në lekë me kursin në ditën e kryerjes së pagesës (njërin prej versioneve).
6. Ambientet për të cilat DPD do të paguajë qira direkte sipas përcaktimit të pikës 4, më sipër do të përdoren specifikisht në ushtrim të funksionit të autoritetit doganor (kontroll, mallra të sekuestruara, peshim e matje, parkim mjeteve të bllokuara si dhe parkim mjeteve të administratës, arkivë) për të cilat shoqëria "Continental" sh.a. nuk ka të drejtë të vjelë të ardhura. Administrimi, mbikëqyrja dhe kontrolli bëhet për të gjithë zonën nga autoriteti doganor sipas legjislacionit përkatës (specifikimi do të bëhet në draft-kontratë).
7. Qiramarrësi bie dakord që ambientet e marra me qera nuk do të nënkontraktohen.
8. Brenda tre muajve nga nënshkrimi, midis Palëve hartohet një protokoll operimi, trajtimi, procesimi për zonën dhe mjetet.
9. Marrëdhënia e qiradhënies dhe të drejtat dhe detyrimet mes Palëve do të rregullohen sipas dispozitave të Kodit Civil, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në kontratën ekzistuese.

Anëtarë të Grupit Negociator

Ilia Bili

Zv/Drejtor i Përgjithshëm Administrativ

Petrit Koçiaj

Kryetar i Degës së Doganës Tiranë

Përfaqësues "Continental Group" sh.a

Administratori

Shefzet Jato

CONTINENTAL GROUP Sh.a
VORË TIRANË

Tel 600220 Fax 600231



**VENDIM****Nr. 609, datë 27.10.2017****PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT NGA TOKË “ARË” NË TOKË
“TRUALL”, PËR NDËRTIMIN E
OBJEKTIT “VEPËR INDUSTRIALE -
MAGAZINË”, NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE KASHAR, BASHKIA
TIRANË, ME ZHVILLUES SHOQËRINË
“MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga tokë “arë” në tokë “truall”, të sipërfaqes prej 27 915.70 (njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë

pikë shtatëdhjetë) m², sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e objektit “Vepër industriale - magazinë”, në njësinë administrative Kashar, Bashkia Tiranë, me zhvillues shoqërinë “Marketing & Distribution” sh.p.k.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun Tiranë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë “arë” në tokë “truall”, për sipërfaqen prej 27 915.70 (njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë) m², sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Lidhja 1

Bashkia	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m ²)
Tiranë	Kashar	Kashar	2105	996/3	Shoqëria “Veramentia” sh.p.k.	Arë	V	3 580
Tiranë	Kashar	Katundi i Ri	2119	105/10	Shoqëria “Veramentia” sh.p.k.	Pemëtore	VI	4 480
Tiranë	Kashar	Katundi i Ri	2119	97/22	Shoqëria “Veramentia” sh.p.k.	Arë	VI	7 945.30
Tiranë	Kashar	Kashar	2105	1106/22	Shoqëria “Veramentia” sh.p.k.	Vresht	V	808
Tiranë	Kashar	Kashar	2105	1104/14	Shoqëria “Veramentia” sh.p.k.	Vresht + pemëtore	VI	2 075
Tiranë	Kashar	Kashar	2105	1106/23	Shoqëria “Veramentia” sh.p.k.	Vresht	VI	4699.40
Tiranë	Kashar	Kashar	2105	95/18	Shoqëria “Veramentia” sh.p.k.	Arë	VI	4 328
TOTALI								27915, 70

**VENDIM****Nr. 610, datë 27.10.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 7, DATË 11.1.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOQSHME PËR VITIN 2017 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 7, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Tabela

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
29	Zyra Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	3			
	Gjykatat e Apelit Tiranë	1	Sanitar	8 orë / ditë	3- muaj
	Gjykata Administrative e Rrethit Vlorë	1	Sekretare Gjyqësore	8 orë / ditë	3- muaj
	Gjykatat e Rretheve Dibër	1	Punonjës sigurie	8 orë / ditë	3- muaj
73	Komisioni Qendro i Zgjedhjeve	7			
	Aparati i KQZ	7	operator/arkivist	8 orë / ditë	3- muaj
87	Institucione te tjera qeveritare	2			
	Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale	1	Sanitar	8 orë /ditë	3- muaj
	Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale	1	Puntor mirmbajtjeje	8 orë /ditë	3- muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	12			

1. Në pikën 1 të vendimit, numri i punonjësve dhe i praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “...2 401 punonjës.”.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1 të vendimit, bëhen këto shtesa:

Në ndarjet “Gr. 29 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”, “Gr. 73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, “Gr. 87 Institucione të tjera qeveritare”, shtohen nëndarjet përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në pikën 2 të vendimit, pas fjalëve “... Drejtorisë së Dëshmshpërblimit të ish-të Përndjekurve Politikë ...” shtohen “... dhe tre punonjësit e kontraktuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 613, datë 27.10.2017**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL,
PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE TË
PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë

dhe Zhvillimit Rural, për Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, sipas lidhjes 1, me 9 (nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i Pushtetit Qendror: MBZHRAU
Bashkia Sarandë
Fusha e përdorimit të pronës: Peshkim

Asete: Manastir – Butrint

Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	3831	28	Truall ndërtese	Godinë e peshkatarëve, Butrint+Prite	596	195	Magazinë	MBZHR	DSHPA	
2	3846	42	Truall ndërtese	Godinë e peshkatarëve, Reze+Prite	579	41	Magazinë	MBZHR	DSHPA	
3	2297	1/601	Truall ndërtese	Godinë midhjesh, Manastir	480	278	Magazinë	MBZHR	DSHPA	
4	2297	1/129	Truall	Sipërfaqe trualli, Manastir, Sarandë	1500		Truall	MBZHR	DSHPA	
5	2297	1/130	Ndërtesë	Godinë midhjesh (depo)		102.7	Magazinë	MBZHR	DSHPA	
6	2297	1/130	Ndërtesë	Kabina elektrike		12.2	Furnizim me energji	MBZHR	DSHPA	
7	2297	1/129	Ndërtesë	Qendra e Grumbullimit të Midhjesh, Manastir		512.8	Në shërbim të subjekteve të midhjesh	MBZHR	DSHPA	
8	2297	1/138	Bankinë	Molo bankinë, Manastir	72	72	Ankorim varkash	MBZHR	DSHPA	
9	2297	6/220	Objekt	Vaskë deporimi, Vrahiol	230.6	230.6	Truall	MBZHR	DSHPA	
10	2297	6/256	Objekt	Hangar përp. midhjesh, Vrahiol	60	60	Truall	MBZHR	DSHPA	
11	2297	6/220	Objekt	Peshore, Vrahiol	85.3	85.3	Truall	MBZHR	DSHPA	
12	2297	6/222	Objekt	Depo uji, Vrahiol	20	20	Truall	MBZHR	DSHPA	
13	2297	6/256	Objekt	Depo karburanti, Vrahiol	44.6	44.6	Truall	MBZHR	DSHPA	
14	2297	1/130	Rrugë	Rruga Sektori midhjesh – Manastir	1620		Futjen në objekt	MBZHR	DSHPA	
15	2297	6/220	Rrugë	Rruga Sektori midhjesh – Vrahiol			Futjen në objekt	MBZHR	DSHPA	
16	1430		Kanal	Kanali i Ujit të Ëmbël, Bistricë	24000		Furnizimin e liqenit të Butrintit me ujë të ëmbël	MBZHR	DSHPA	



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i pushtetit qendror: MBZHRAU

Bashkia Sarandë

Fusha e përdorimit të pronës: Peshkim

Asete: Porti i Peshkimit Sarandë

Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	8641	4/19 4/108 5/162	Truall	Sipërfaqe trualli + bankinat	4404		Truall funksional	MBZHR	DSHPA	
2	8642	1/286	Ndërtesë	Oficinë mekanike		240	Ndërtesë	MBZHR	DSHPA	
3	8642	1/286	Ndërtesë	Zyrat		120	Zyra	MBZHR	DSHPA	
4	8641	5/162	Ndërtesë	Kabina e rojës		11.5	Rojë e objektit	MBZHR	DSHPA	
5	8642	1/286	Bankinë	Bankinë (nga marina)		62	Ankorim anijesh	MBZHR	DSHPA	

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i pushtetit qendror: MBZHRAU

Bashkia/Komuna Vlorë

Fusha e përdorimit të pronës: Peshkim

Asete: Porti i Peshkimit Vlorë

Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	8604			Sipërfaqe trualli	101200		Truall funksional			
2	8604	47/9	Ndërtesë	Policia kufitare, obj. 2		230.6	Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	
3	8604	47/13	Ndërtesë	Repart rrjetash, obj. 3		241.4	Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	
4	8604	47/15	Ndërtesë	Zyra dhe H/S		241.7	Zyra	MBZHR	DSHPA	
5	8604	47/23	Ndërtesë	Markato peshku, obj. 5		1361.5	Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	
6	8604	47/18	Ndërtesë	Oficina (repart + zyra), obj. 7		1003.6	Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	
7	8604	47/11	Ndërtesë	Kabina e rojës		10.4	Rojë për objektet	MBZHR	DSHPA	
8	8604	47/10	Ndërtesë	Kabina elektrike		21.7	Për furnizim me energji	MBZHR	DSHPA	
9	8604	47/7	Ndërtesë	Dhoma e distributorit + dhoma e dokumenteve, obj. 14		106.9	Ndërtesë	MBZHR	DSHPA	



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i pushtetit qendror: MBZHRAU

Bashkia Lezhë

Fusha e përdorimit të pronës: Peshkim

Asete: Porti i Peshkimit Shëngjin

Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	3126		Truall	Sipërfaqe trualli (6023+3303)	9326		Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	
2	3126		Ndërtesa	Kapanoni, objekti nr. 1		1069.29	Riparim rrjetash	MBZHR	DSHPA	
3	3126		Ndërtesa	Zyrat dhe H/S 2K, objekti nr. 3		75.9	Zyra	MBZHR	DSHPA	
4	3126		Ndërtesa	Truprojë		74	Jashtë funksionit	MBZHR	DSHPA	
5	3126		Ndërtesa	Kabinë gjeneratori		10	Jashtë funksionit	MBZHR	DSHPA	
6	3126		Të tjera ndërtimore	Molo druri, obj. nr. 4		340	Ankorim anijesh	MBZHR	DSHPA	
7	3126		Të tjera ndërtimore	Bankinë e marinës, obj. Nr. 5		323	Ankorim anijesh	MBZHR	DSHPA	
8	3126		Të tjera ndërtimore	Bankinë gjuajtësi		295	Ankorim anijesh	MBZHR	DSHPA	
9	3126		Të tjera ndërtimore	Bankina e shkallës		147	Riparim anijesh	MBZHR	DSHPA	



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i pushtetit qendror: MBZHRAU

Bashkia Shkodër

Fusha e përdorimit të pronës: Peshkim

Asete: Porti i Peshkimit Shirokë

Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	8595	3/52	Truall	Sipërfaqe trualli	1500		Truall funksional	MBZHR	DSHPA	
2	8595	3/52	Ndërtesë	Ndërtesa e përpunimit të peshkut		200	Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	
3	8595	3/52	Ndërtesë	Ndërtesë 2-katëshe		200	Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	
4	8595	3/52	Kanal	Kanali Shirok {63 ml*(11–8)}	693		Për derdhjen e ujërave në liqen	MBZHR	DSHPA	

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i pushtetit qendror: MBZHRAU

Bashkia Shkodër

Fusha e përdorimit të pronës: Peshkim

Asete: Porti i Peshkimit Zogaj

Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	8596		Truall	Sipërfaqe trualli	626		Truall funksional	MBZHR	DSHPA	
2	8596	2/147	Ndërtesë	Zyrat		60	Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	
3	8596	2/137	Ndërtesë	Dhoma e rojës		12.7	Në funksion të peshkatarëve	MBZHR	DSHPA	



1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i pushtetit qendror: MBZHRAU
Bashkia Pogradec
Fusha e përdorimit të pronës: Peshkim

Ekonomia e Rritjes së Rasateve, Lin, Pogradec

Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2457	24	Truall	Sipërfaqe truall (vaskat e peshkimit)	3600		Truall funksional	MBZHR	DSHPA	
2	2457	22/1	Ndërtesë	Godinë peshkimi	393	222	Zyra + magazinë + inkubator	MBZHR	DSHPA	
3	2457	572	Truall	Kanal	4000		Furnizim me ujë	MBZHR	DSHPA	

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

Institucioni i pushtetit qendror: MBZHRAU
Bashkia Korçë
Fusha e përdorimit të pronës: Peshkim

Asete: Ekonomia e Rritjes së Rasateve, Zvezdë, Korçë

Nr. rendor	Zona kadastr. dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	1321	460/1	Truall	Sipërfaqe truall dhe vaska peshku	72860		Rritje rasatesh	MBZHR	DSHPA	
2	1321	460/1	Ndërtesë	Ndërtesë ekonomike		36	Zyra	MBZHR	DSHPA	
3	1321	460/1	Ndërtesë	Inkubator + depo ushqimi		93	Magazina	MBZHR	DSHPA	



VENDIM

Nr. 614, datë 27.10.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 18, DATË 11.1.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN
E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE
SPITALORE NGA SKEMA
E DETYRUESHME E SIGURIMEVE
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
PËR VITIN 2017”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 14, të ligjit nr. 130/2017, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

Buxhet 2017

Buxheti i shërbimit spitalor 2017

VENDOSI:

1. Shtojca 2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për spitalet, për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA 2

000 lekë

Nr.	SPITALET	Buxhet 2017					
		6000000	6010000	6020000	60400000	6060000	Total
1	BERAT	242,700	40,220	172,900			455,820
2	BULQIZË	66,000	10,670	25,950			102,620
3	DELVINË	29,100	4,720	5,850			39,670
4	DEVOLL	41,800	6,900	12,750			61,450
5	DIBËR	219,400	36,000	122,100			377,500
6	ELBASAN	370,400	61,085	279,010			710,495
7	FIER	321,500	53,350	189,550			564,400
8	GRAMSH	98,500	16,300	36,850			151,650
9	GJIROKASTËR	181,000	29,272	130,734			341,006
10	HAS	35,430	5,750	13,272			54,452
11	KAVAJË	96,900	15,740	33,550			146,190
12	KOLONJË	75,500	12,220	21,450			109,170
13	KORÇË	352,700	58,450	218,300			629,450
14	KRUJË	105,650	17,420	26,350			149,420
15	KUÇOVË	55,500	9,600	17,182			82,282
16	KUKËS	199,000	32,700	140,200			371,900
17	KURBIN	70,600	11,730	30,750			113,080
18	LEZHË	201,700	33,220	120,700			355,620
19	LIBRAZHD	123,000	20,100	50,700			193,800
20	LUSHNJË	194,100	31,720	112,300			338,120
21	MALËSI E MADHE	18,700	3,130	6,350			28,180
22	MALLAKASTËR	37,150	6,200	11,655			55,005
23	MAT	102,350	17,060	46,350			165,760



24	MIRDITË	86,550	14,150	31,900			132,600
25	PEQIN	29,550	4,870	5,980			40,400
26	PËRMET	71,835	11,870	27,300			111,005
27	POGRADEÇ	142,650	23,450	74,750			240,850
28	PUKË	79,600	12,850	36,700			129,150
29	SARANDË	126,800	20,600	77,400			224,800
30	SKRAPAR	72,700	12,060	19,000			103,760
31	SHKODËR	450,200	74,700	224,184			749,084
32	TEPELENË	79,250	13,050	19,950			112,250
33	QSUT	1,912,705	315,280	4,056,835			6,284,820
34	SUOGJ “MBRETËRESHA GERALDINË”	265,000	43,800	278,750			587,550
35	SUOGJ “KOÇO GLIOZHENI”	209,200	34,340	194,250			437,790
36	SU “SHEFQET NDROQI”	277,520	45,850	361,147			684,517
37	TROPOJË	86,400	14,175	35,350			135,925
38	VLORË	343,900	56,850	287,500			688,250
39	SU TRAUMA	92,500	14,900	123,145			230,545
	Paketat e shërbimeve				1,495,721		1,495,721
	Trajtime me VKM				50,000		50,000
	Transferta për individët (mjekë specialistë)					15,000	15,000
	Pagesa të shërbimeve PPP				1,473,277		1,473,277
	TOTALI	7,565,040	1,246,352	7,678,944	3,018,998	15,000	19,524,334

VENDIM

Nr. 615, datë 27.10.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 645, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN DHE
MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË
KOMISIONIT TË ÇMIMIT TË BARNAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 38, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 645, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Në shkronjën “a”, të pikës 2, dhe në të gjithë përmbajtjen e këtij vendimi, emërtimi “Drejtoria Farmaceutike” zëvendësohet me “Sektori i rregullimit të tregut farmaceutik dhe pajisjeve mjekësore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 616, datë 27.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI DHE
RIVITALIZIMI I PARKUT “AQIF
PASHA””, NË BASHKINË E ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi dhe rivitalizimi i parkut “Aqif Pasha””, në Bashkinë e Elbasanit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë “ndërtesë”,



me sipërfaqe 325.30 (treqind e njëzet e pesë pikë tridhjetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 20 942 901,83 (njëzet milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e një presje tetëdhjetë e tre) lekësh, si dhe “truall”, me sipërfaqe 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) m², me vlerë 2 131 896 (dy milionë e njëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 23 074 797,83 (njëzet e tre milionë e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë presje tetëdhjetë e tre) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Elbasan.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Elbasan, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) m², “truall”, për projektin “Zgjerimi dhe rivitalizimi i parkut “Aqif Pasha””, të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA PERBLEDHESHE
E VLERESIMIT TE SHPRONSIMIT PER INTERES PUBLIK
TE PRONARIT TE PASURISE TE PALUAJTSHME, PRONE PRIVATE
E CILA PREKET NGA “ZGJERIMI dhe RIVITALIZIMI i parkut “Aqif Pasha”, ELBASAN

Nr	Familja	Nr	Vertetimi pronesisë		TRUALL				BANESA				NJESI				SHUMAT	Vendi
			m ²	shpronsim	cmimi	shpronsim	Sip banes m ²	cmimi	shpronsim	Sip njesisë m ²	cmimi	shpronsim	preket	shpronsim	leke/m ²	leke	leke	
	që shpronsohet	Pas	truall	banes	njesi	m ²	leke/m ²	leke	preket	shpronsim	leke/m ²	leke	preket	shpronsim	leke/m ²	leke	leke	
1	Mahir Musa Hoxha	1/252	156	0.00	140	156.00	13666	2131896.00	0.00	0.00	35746.87	0.00	325.30	325.30	64189.27	20942901.83	23074797.83	Bashkia Soc
			0.00	0.00	185.3													Gra Albania
						0.00		2131896.00				0.00					20942901.83	23074797.83

URDHËR
Nr. 112, datë 26.10.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të nenit 14, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 28, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, nga data 30 tetor deri në datën 3 nëntor 2017, zëvendëskryetarit të AMA-s, Sami Nezaj.

2. Ngarkohet zëvendëskryetari, z. Sami Nezaj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gentian Sala

URDHËR
Nr. 521, datë 18.10.2017

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie, z. Koli Bele.

2. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të ushtrohen për një periudhë të



pacaktuar, në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Lindita Nikolla

VENDIM
Nr. 40, datë 6.10.2017

**PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME TIRANË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë, me:

Drejtues ligjor: Redi Molla;

Drejtues teknik: Ortion Dhami, Edgar Çani.

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria B: Për përpunimin e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Tiranë, Kamzë (pjesërisht), Vorë (pjesërisht).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 1-vjeçare (njëvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 41, datë 6.10.2017

**PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS
GRAMSH**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës Gramsh, me:

Drejtues ligjor: Tajar Bici;

Drejtues teknik: Miranda Bici.

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Gramsh autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Gramsh.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

**VENDIM****Nr. 43, datë 6.10.2017****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 33, DATË 6.9.2017, “PËR LICENCIMIN
E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
MALIQ”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 33, datë 6.9.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Maliq”, bëhen këto ndryshime:

1. Drejtues teknik: Astrit Hasani.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

VENDIM**Nr. 44, datë 6.10.2017****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME LEZHË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lezhë, me:

Drejtues ligjor: Zef Maçi;

Drejtues teknik: Petrit Bardhi.

2. Operatori sh.a Ujësjiellës Lezhë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Lezhë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë